

VENDIM
Nr. 138, datë 6.3.2026

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 26.8.2025, PËR ÇËSHTJEN “KROI DHE NOÇKA KUNDËR SHQIPËRISË” (PËR KËRKESËN NR. 84056/17)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”; të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 26.8.2025, për çështjen “Kroi dhe Noçka kundër Shqipërisë”, për kërkesën nr. 84056/17, përfundimtar në datën 26.11.2025, sipas shumave të përcaktuara në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Vlerat e përcaktuara si detyrim në pikën 1, të këtij vendimi, konvertohen në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës ku depozitohet shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

3. Vlerat e përcaktuara si detyrim, në pikën 1, të këtij vendimi, depozitohen në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të kërkuësve, sipas shtojcës 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi, në vlerën që shteti shqiptar detyrohet, sipas vendimit përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 26.8.2025, për çështjen “Kroi dhe Noçka kundër Shqipërisë”, kërkesa nr. 84056/17, për secilin kërkuës.

4. Pagimi i shumave të depozituara, sipas përcaktimeve në pikën 3, të këtij vendimi, në favor të dy kërkuësve, bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm ligjor për kryerjen e pagesave nga buxheti i shtetit, brenda afatit 3-mujor nga dita kur vendimi i gjykatës është bërë përfundimtar.

5. Në rast mospagimi brenda afatit 3-mujor, të përmendur në pikën 4, të këtij vendimi, mbi shumat e sipërpërmendura paguhen interesa të thjeshtë, të barabartë me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind.

6. Efektet financiare, të parashikuara për ekzekutimin e këtij vendimi, përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2026.

7. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA 1

Nr. i kërkesës	Emri i çështjes	Kërkuesit	Dëm jopasuror	Kostot dhe shpenzimet¹
84056/17	Kroi dhe Noçka k. Shqipërisë	Agim Kroi	3.600 (tre mijë e gjashtëqind) euro	4000 (katër mijë) euro bashkërisht të dy kërkuesve
84056/17	Kroi dhe Noçka k. Shqipërisë	Albert Noçka	3.600 (tre mijë e gjashtëqind) euro	

¹ Plus cdo taksë që mund të jetë e aplikueshme mbi kostot dhe shpenzimet